



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**  
**K.P.P. 193/2021**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 06.05.2021 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:**

Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “MUCA” SHPK, në procedurën e prokurimit “*Kërkesë për Propozim*”, me nr. REF-87845-02-22-2021, me objekt: “*Blerje uniforme për Policinë Bashkiake*”, me fond limit 3.666.000 lekë (pa TVSH), zhvilluar më datë 05.03.2021, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së lidhur me skualifikimin e operatorit ekonomik “*Enea Masllavica*” Person Fizik, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

**Ankimues:**

“MUCA” SHPK.

Adresa: Autostrada Tiranë – Durrës, Km 13, Picar, Vorë.

“Enea Masllavica” Person Fizik.

Adresa: Rruga “Bajram Curri”, pranë Komisariatit 4, Tiranë.

**Subjekte të interesuar:**

“ATLANTIK 3” SHPK.

Adresa: Rruga: “Autostrada Tiranë – Durrës”, km 10, Vorë, Tiranë.

“UNIVERS PROMOTIONS” SHPK.

Adresa: Mbikalimi i Rinasit, Qafa e Kasharit, Kashar, Tiranë.

“MURATI D” SHPK.

Adresa: Rruga e Kavajës, Ish- Kombinati Ushqimor, Godinë 1- katëshe Tiranë.

“Gentian Sadiku” Person Fizik.

Adresa: Njësia Bashkiake nr.5, Rruga “Zef Jubani”, pallati 24, kati i parë Tiranë.

**Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Durrës.  
Adresa: Sheshi “Liria”, Qyteti Durrës.

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtimet me shkrim të ankimuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## Vëren:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë interes për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.2. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të bazuar në pikën 1 të nenit 63 të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas kanë paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Ligjin Nr.9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.4. Operatorët ekonomikë kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të operatorëve ekonomikë ankimes “MUCA” SHPK dhe “Enea Masllavica” Person Fizik.

## II

### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 24.02.2021, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Kërkesë për Propozim*”, me nr. REF-87845-02-22-2021, me objekt: “*Blerje uniforma për Policinë Bashkiake*”, me fond limit 3.666.000 lekë (pa TVSH), zhvilluar më datë 05.03.2021, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

II.2. Në datën 05.03.2021, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 11.03.2021 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “MUCA” SHPK	3145300.00	skualifikuar
2. “ATLANTIK 3” SHPK	3184020.00	skualifikuar
3. “UNIVERS PROMOTIONS” SHPK	3188310.00	skualifikuar
4. “ENEAS MASLLAVICA” Person Fizik	3218800.00	skualifikuar
5. “MURATI D” SHPK	3246500.00	skualifikuar
6. “GENTIAN SADIKU” SHPK	3441200.00	skualifikuar

II.4. Në datën 11.03.2021, operatori ekonomik “MUCA” SHPK është njoftuar elektronikisht për vlerësimin e procedurës së prokurimit, si dhe skualifikimin e tij në procedurën e mësipërme të prokurimit me pretendimin se:

“- O.E MUCA me vlerë të ofertës 3.145.300 lekë, nuk ka përmbushur kërkesat për kualifikim të kërkuara në dokumentet e tenderit e konkretisht:

- Në Shtojcën 8 të DT, në kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 2.3 “Për kapacitetin teknik” është kërkuar: Furnizimet e mëparshme, të ngjashme, në një vlerë jo më të ulët se 1.200.000 lekë, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit; Dëshmitë për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me ent publik, duhet të paraqesë Kontratë/Kontrata të nënshkruara të shoqëruara me vërtetim për realizimin e tyre dhe fatura tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

O.E MUCA nuk e përmbush kriterin e mësipërm, pasi faturat e paraqitura me sektorin privat, nuk janë furnizime për uniforma për Policinë Bashkiake ose të ngjashme me to, ose p.sh. uniforma policie ushtrie, uniforma zjarrfikëse e të tjera si këto, por furnizime për artikuj ndërtimi dhe industrial. KVO vendos që O.E MUCA të mos kualifikohet.”.

II.5. Operatori ekonomik “MUCA” SHPK, në datën 16.03.2021 ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij, sipas pretendimeve si më poshtë vijon:

*Rrethanat e faktit:*

Më datë 05.03.2021, AK- BASHKIA DURRËS, ka zhvilluar tenderin me objekt prokurimi: "BLERJE UNIFORMA PËR POLICINË BASHKIAKE", dhe fond limit: 3.666.000 (Tre milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë) lekë pa TVSH.

Shoqëria jonë me përvojë shumëvjeçare, ka marrë pjesë në këtë garë, duke dorëzuar ofertën e saj shoqëruar me të gjithë dokumentet e kërkuara në DT, sipas LPP, dhe të VKM për RRPP.

Më datë 11.03.2021, ora 11.41, nëpërmjet SPE, na vjen mesazhi nga KVO-ja e AK- BASHKIA DURRËS, nëpërmjet të cilit:

- njoftohemi për klasifikimin e ofertuesve, ku shohim që oferta jonë është refuzuar, si më poshtë:

Operatorët ekonomikë	Vlerat e Ofertuara	Refuzuar
MUCA	3145300.00	Po
ATLANTIK 3	3184020.00	Po
UNIVERS PROMOTIONS	3188310.00	Po
ENEA PASLLA VICA	3218800.00	Po
MURATI D	3246500.00	Po
GENTIAN SADIKU	3441200.00	Po

- Si dhe njoftohemi për arsyen e refuzimit të ofertës tonë, si më poshtë:

"- O.E MUCA me vlerë të ofertës 3.145.300 lekë, nuk ka përmbushur kërkesat për kualifikim të kërkuara në dokumentet e tenderit e konkretisht:

- Në Shtojcën 8 të DT, në kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 2.3 “Për kapacitetin teknik” është kërkuar: Furnizimet e mëparshme, të ngjashme, në një vlerë jo më të ulët se 1.200.000 lekë, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit; Dëshmitë për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me ent publik, duhet të paraqesë Kontratë/Kontrata të nënshkruara të shoqëruara me vërtetim për realizimin e tyre dhe fatura tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara.

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara.

O.E MUCA nuk e përmbush kriterin e mësipërm, pasi faturat e paraqitura me sektorin privat, nuk janë furnizime për uniforma për Policinë Bashkiake ose të ngjashme me to, ose p.sh. uniforma policie, uniforma ushtrie, uniforma zjarrfikëse e të tjera si këto, por furnizime për artikuj ndërtimi dhe industrial. KVO vendos që O.E MUCA të mos kualifikohet."

Shoqëria "MUCA" SHPK, në mbështetje të Ligjit dhe nisur nga interesi i ligjshëm i saj për të fituar kontratën, kundërshton vendimin e KVO-së përkatëse, duke paraqitur Formularin e Ankesës pranë "AK", brenda afateve ligjore, mbështetur në nenin 63, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, duke respektuar shkallët e ankimit, me anë të së cilit kërkojmë:

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së për skualifikimin e shoqërisë tonë, duke e shpallur atë të kualifikuar:

- KUNDËRSHTOJMË VENDIMIN E KVO-së, në lidhje me skualifikimin e shoqërisë tonë me argumentet dhe faktet si më poshtë vijon:

Së pari:

Mendojmë se KVO-ja, nuk e ka vlerësuar me vëmendje dhe seriozitet ofertën tonë dhe dokumentet shoqëruese të saj, duke mos vërejtur artikujt dhe mallrat në përbërje të faturave të shitjes të dërguara nga ana jonë si furnizime të ngjashme me artikujt e këtij tenderi.

Së dyti:

Në DT, në shtojcën 8 të DT, në kriteret e veçanta për kualifikim, pika 2.3. "Për kapacitetin teknik" është kërkuar:

a. Furnizimet e mëparshme, të ngjashme, në një vlerë jo më të ulët se **1.200.000** lekë, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit; Dëshmitë për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me ent publik, duhet të paraqesë Kontratë/Kontrata të nënshkruara të shoqëruara me vërtetim për realizimin e tyre dhe fatura tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara.

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet te paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara.

Si dhe në shtojcën 10 të DT, "Sasia dhe grafiku i lëvrimit", artikujt përbërës të kësaj procedure janë:

<b>Nr.</b>	<b>Artikulli</b>	<b>Njësia</b>	<b>Sasia</b>	<b>Çmimi</b>	<b>Vlera</b>
1	Kostume	copë	38		
2	Xhiboks	copë	38		
3	Pantallona verore	copë	160		
4	Pantallona dimërore	copë	160		
5	Këmishë me mëngë të shkurtra	copë	160		
6	Këmishë me mëngë të gjata	copë	160		
7	Kollare	copë	80		
8	Kapele verore	copë	160		
9	Emblema kapele	copë	80		
10	Emblema krahu	copë	80		
11	Këpucë dimërore	copë	80		
12	Këpucë verore	copë	80		
13	Pulovra	copë	80		
14	Bluza	copë	160		
15	Rrip mesi	copë	38		
16	Pranga	copë	19		
17	Shkopinj Gome	copë	20		
18	Atlete Uniforme	copë	10		
19	Pelerina shiu	copë	10		
20	Kapele uniforme	copë	37		
21	Kostum ceremonial	copë	10		
22	Elektrik i thjeshte	copë	10		
23	Çizme Gome	copë	10		
	<b>Totali</b>				
	<b>TVSH 20%</b>				
	<b>TOTALI me TVSH</b>				

Në plotësim të kësaj kërkesë OE “MUCA” SHPK, ka paraqitur shumë fatura tatimore shitje, brenda të cilave, ka shumë artikuj të njëjtë ose të ngjashëm me artikujt e preventivit të kësaj procedure, shuma e vlerave të shitjes se të cilëve është mbi 6.870.000 lekë, pra disa herë më e madhe se vlera 1.200.000 e kërkuar në kërkesat për kualifikim.

Më konkretisht:

<b>File</b>	<b>faq e</b>	<b>Nr. fat</b>	<b>data</b>	<b>artikulli</b>	<b>Nr. I artik ne fature</b>	<b>Vlera pa TVSh/leke</b>

8-TE NGJASHME etj-18-1	13	5779	09.03.2018	Çizme	2	4500
	14	5806	09.03.2018	Këpucë	21	11667
	14	5806	09.03.2018	Çizme	22	7392
	18	5904	19.03.2018	Dorashka	18,19,20,94	411 euro =542521e ke
	24	5929	21.03.2018	Ndriçues	3	570
	24	5929	21.03.2018	Çizme	6	5000
	25	6038	28.03.2018	Kominoshe	1	6667
	32	6091	31.03.2018	Elektrike dore	1	3300
	34	5939	21.03.2018	Elektrike dore	8	2200
	36	8036	24.04.2028	Kominoshe	10	12000
	38	9161	14.04.2018	Elektrike dore	14	3750
	41	9801	22.05.2018	Kominoshe	1	23333
	43	9964	31.05.2018	Kominoshe	23	6458
	45	9477	02.05.2018	Elektrike dore	1	3600
	47	9655	11.05.2018	Bluze dhe pantallona burrash	1,2,3	1735800
	48	362	25.06.2018	Këpucë verore	1,2	30000
	40	427	28.06.2018	Elektrike dore	3	25000
	52	761	20.07.2018	Elektrike dore	4	4333
9-TE NGJASHME etj-18-2	2	967	04.08.2018	Çizme	7	9120
	4	7905 6	14.08.2018	Elektrike dore	1	7250
	7	7981 7	29.09	Këpucë	33,34	19833
	11	7974 7	26.09	Kokore	1	4167
	13	7979 2	28.09	Kokore, Doreza, këpuce	1,2,7,8	14063
	14	7954 3	13.09	Elektrike dore	5	1275
	16	7957 7	14.09	Elektrike dore	1	4320
	18	7950 3	10.09	Elektrike dore	4	2000
	22	7824 6	30.11	Këpucë, doreza	15,16	15900

	24	7822 4	30.11	këpuce	6,7	10600
	26	7817 0	24.11	Kominoshe	7	9400
	30	7787 0	6.11	Kominoshe	11	4850
	34	7816 7	24.11	Jelekë, kokore	3,1	7458
	36	1187	14.11	Jelekë, bluza	1,2	750645
	37	7853 6	20.12	këpuce	1	14167
	39	7843 9	13.12	Ndriçues, Jelekë, këpuce	11,12,13,18, 22	47462
	41	7847 6	15.12	këpuce	1	10000
	43	7863 8	27.12	këpuce	1	12000
	44	7840 0	10.12	Ndriçues, kapele, kominoshe, rripa, doreza	1,2,3,5,11	66800
	45	7860 1	26.12	Doreza, kokore	1,2	23417
10-TE NGJASHME etj-19-1	7	154	17.01.2019	Veshje, kostume shiu	57,58	40833
	9	260	24.01	Kapele, doreza, jelekë, rripa, ndriçues, kostume shiu	1,2,3,4,5,10, 11	52160
	14	194	19.01	pelerina	3	10833
	16	304	28.01	rripa	10	15000
	18	362	31.01	Jelekë, doreza	4,5	34600
	19	224	22.01	pelerina	2	10833
	21	408	5.02	këpuce	10	18667
	34	4282 5	2.04	këpuce	6	46667
	36	5363	16.04	Jelekë, rripa, ndriçues, këpuce	2,4,5,6	20255
	37	5403	7.05	këpuce	1	30000
	39	2058 8	24.05	bluza	1,2	666668



	42	2082 9	8.06	<i>Këpucë, jelekë</i>	1,2,3	
	44	2099 5	19.06	<i>bluza</i>	1,2	750182
	50	2135 8	12.07	<i>këpuce</i>	1	24000
	51	2149 3	20.07	<i>bluza</i>	1	124630
	52	2150 6	23.07	<i>bluza</i>	1	123600
	58	2321 6	12.11	<i>këpuce</i>	1	29250
	61	2337 6	21.11	<i>Këpucë, mushama shiu</i>	1, 2	22458
<i>10-TE NGJASHME etj-19-2</i>	1	2321 1	22.11.2019	<i>kostume shiu</i>	9,10	35608
	3	2329 4	5.11	<i>Këmisha, bluza, Jelekë</i>	1,2,3,4	666981
	5	5943	31.12	<i>Çizme, këpuce, kapele</i>	1,2,10	45100
	42	2156 0	26.07	<i>këpuce</i>	9	16250
	53	2347 0	30.11	<i>këpuce</i>	1	12000
	55	2331 6	19.11	<i>Këpucë, doreza</i>	1,2	37167
	59	5852	14.11	<i>Çizme, kostume shiu</i>	9,11	15000
<i>12-TE NGJASHME etj-19-20</i>	8	6226	29.06.2020	<i>Çizme, kominoshe, këpuce</i>	3,4,5	51150
	9	2282	13.06	<i>Jelekë, doreza, kominoshe, këpucë</i>	1,2,3,5,6	65890
	16	4005	30.09	<i>këpuce</i>	1	30000
	17	4412	24.1	<i>këpuce</i>	3	24000
	21	3970	29.09	<i>Uniforma zjarrfikësi</i>	1,2,3,4	414000
	22	2486	03.01.2019	<i>përparëse</i>	1	28980
	23	5423	22.12.2020	<i>Jelekë, pelerina shiu për policinë</i>	4,5	103400

				<i>bashkiake</i>		
<i>13-TE NGJASHME etj-20-1</i>	<i>1</i>	<i>389</i>	<i>28.01.2020</i>	<i>Doreza, jelekë, këpuce</i>	<i>1,2,3</i>	<i>9200</i>
	<i>8</i>	<i>1786</i>	<i>18.05</i>	<i>këpuce</i>	<i>1</i>	<i>21333</i>
	<i>18</i>	<i>2895</i>	<i>18.07</i>	<i>Jelekë, Rripa</i>	<i>25,30,31,32</i>	<i>16365</i>
	<i>32</i>	<i>3589</i>	<i>4.09</i>	<i>Çizme, jelekë, kostume dhe pelerina shiu</i>	<i>9,12,13,14</i>	<i>38960</i>
	<i>38</i>	<i>4000</i>	<i>30.09</i>	<i>Çizme, kominoshe</i>	<i>1,3</i>	<i>12465</i>
<i>14-TE NGJASHME etj-20-2</i>	<i>5</i>	<i>4143</i>	<i>09.10.2020</i>	<i>pelerina</i>	<i>5,12</i>	<i>39083</i>
	<i>6</i>	<i>4412</i>	<i>24.1</i>	<i>këpuce</i>	<i>3</i>	<i>24000</i>
	<i>8</i>	<i>4279</i>	<i>16.1</i>	<i>Këpucë, Çizme, pelerina, Jelekë</i>	<i>1,2,3,4</i>	<i>40584</i>
	<i>10</i>	<i>4643</i>	<i>6.11</i>	<i>këpuce</i>	<i>1</i>	<i>31667</i>
	<i>14</i>	<i>5277</i>	<i>15.12</i>	<i>pelerina</i>	<i>1</i>	<i>75000</i>
<b><i>VLERA TOTALE</i></b>						<b><i>6 873 567</i></b>

*Po të vëmë re me kujdes brenda faturave të paraqitura, ka edhe uniforma për zjarrfikëse si dhe uniforma për policinë bashkiake të Bashkisë Durrës!*

*Në bazë të LPP, kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës.*

*Në nenin 27 "Kontratat e Mallrave" pika 4 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar parashikohet se: "Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon: Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.*

*Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent public ose dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

*Sa më sipër interpretimi i kontratave të paraqitura nga "MUCA" SHPK, nëse do të cilësohet si eksperiencë e ngjashme duhet parë në raport me natyrën e mallrave dhe elementeve konkrete të realizimit të tyre që autoriteti kontraktor synon të arrijë të kryejë pas lidhjes së kontratës me operatorin ekonomik të klasifikuar të suksesshëm.*

*Nga tabela e mësipërme konstatohet qartë se me anë të dokumentacionit të mësipërm të dorëzuar, "MUCA" SHPK ka dëshmuar se nga ana e tij janë bërë shitje të artikujve sipas preventivave në shtojcën 10 "Sasia dhe grafiku i lëvrimit" të dokumenteve standarde të tenderit objekt ankimi, referuar shitjeve të mësipërme me autoritete të ndryshme publike dhe private. Mallrat objekt prokurimi të kërkuara nga autoriteti kontraktor janë kryesisht veshje, me sasi të përkatëse për çdo produkt. Referuar objektit dhe preventivave të shitjeve të mësipërcituara rezulton se këto shitje janë të realizuara me sukses dhe në përputhje me afatet e përcaktura. Autoriteti kontraktor nuk mund të pretendojë zëra të ngjashëm për të gjithë zërat e pasqyruar në shtojcën 10 "Sasia dhe Grafiku i Lëvrimit" të dokumenteve të procedurës, pasi një gjë e tillë të çon drejt përcaktimit të zërave të njëjtë të mallrave, në kundërshtim kjo me rregullat e prokurimit publik si më sipërcituar. Një përcaktim i tillë që në vetvete nënkupton eksperiencën të njëjta apo zëra të njëjtë të shërbimeve/punëve publike apo mallrave, bie në kundërshtim edhe me vetë frymën dhe qëllimin e ligjit të përcaktuar në nenin 1 të tij, duke frenuar konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomik dhe duke bërë një trajtim jo të barabartë dhe diskriminues të këtyre operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik.*

*Pra referuar dëshmi të eksperiencës së mëparshme të dorëzuar të realizuar, "MUCA" SHPK ka provuar se ka furnizuar mallra të cilat për nga natyra janë të ngjashme me objektin e procedurës së prokurimit.*

*Në drejtim të dëshmisë së eksperiencës së mëparshme, të ngjashme me objektin e procedurës së prokurimit, sipas ligjit, për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishë të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit. Sa më sipër, autoriteti kontraktor nuk duhet të gjykojë në mënyrë sipërfaqësore e formale, por të analizojë në themel dhe në mënyrë të arsyeshme e proporcionale eksperiencat e dokumentuara nga ofertuesit/kandidatët, në funksion të qëllimit dhe rrethanave faktike për të cilin vendosen kriteret e përcaktuara. Në rastin konkret, neni 46, pika 1, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, është vërtetimi i eksperiencës së mëparshme të operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit me anë të dokumentacionit të dorëzuar në SPE, MUCA ka vërtetuar se ka kryer me sukses, furnizime të ngjashme në përputhje me përqindjen e kërkuar nga autoriteti kontraktor, (40 % të vlerës së fondit limit të kontratës së prokuruar).*

*Për referencë gjykimi, Shih:*

*- Vendimin e KPP.33212017 marrë me 22.05.2017, me 640 prot, dt.03.04.2017.*

*- Vendimin e KPP.85212018, marrë me 19.12.2018, me 1766 prot, dt.22.11.2018.*

*I takonte KVO-së të bënte verifikimet përkatëse. Pas kësaj ankese i takon Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave (KSHA-së) të bëjë këto verifikime dhe rivlerësimin e ofertave.*

*I nderuar Z. Kryetar i AK, në përfundim, të bindur në pretendimet tona të bazuara në ligj dhe në prova, kërkojmë nga ana juaj:*

*Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e shoqërisë "MUCA" SHPK duke e shpallur të kualifikuar.*

*Për sa më sipër, përfundimisht kërkojmë pranimin e ankesës.*

II.6. Me anë të shkresës nr. 1144/7 prot, datë 29.03.2021, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik ankimues, duke mos e pranuar atë sipas pretendimeve si më poshtë vijon:

*Nisur nga ankesa e paraqitur nga operatori ekonomik “MUCA” SHPK, me protokoll me nr.1144/4 Prot, datë 16.03.2021, për kontratën me objekt: “Blerje uniforma për policinë bashkiake”, ju sqarojmë si më poshtë:*

*Komisioni i ngritur me Urdhrin e zëvendëskryetarit të Bashkisë nr. 178, datë 16.03.2021, i përbërë nga z. A.p, z. S.F dhe znj. E.V, mbështetur në Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” dhe në Kreun X, neni 78, pika 5, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën e paraqitur nga Operatori Ekonomik “MUCA” SHPK.*

*Mbas shqyrtimit të dokumentacionit të ndodhur në sistemin elektronik dhe ballafaqimit me shkaqet ku ankuesi mbështet pretendimet e tij, vërehet se:*

*Autoriteti Kontraktor Bashkia Durrës (BD), në bazë të Urdhrit (KVO) nr.1144/2 prot., datë 16.02.2021, ka zhvilluar procedurën e prokurimit “E hapur” (prokurim elektronik), me objekt: “Blerje uniforma për policinë bashkiake”, me fond limit: 3.666.000 lekë (tre milion gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë) lekë, me fondet tona.*

*Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në procedurën për vlerësimin e ofertave, bazuar në metodën e paracaktuar të vlerësimit sipas Udhëzimit nr. 3, datë 05.05.2017 “Për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave në sistemin e prokurimit elektronik”, i ndryshuar, me objekt: “Blerje uniforma për policinë bashkiake”, me fond limit 3.666.000 leke (tre milion gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë) lekë, ka vlerësuar si më poshtë:*

*Oferta të kualifikuara: Nuk ka Oferta të kualifikuara:*

- 1. Operatori ekonomik “ATLANTIK 3”, me vlerë të ofertës 3.184.020 lekë.*
- 2. Operatori ekonomik “ENEA MASLLAVICA & VJOLLCA OSMANI”, me vlerë të ofertës 3.218.800 lekë.*
- 3. Operatori ekonomik “GENTIAN SADIKU”, me vlerë të ofertës 3.441.200 lekë.*
- 4. Operatori ekonomik “MUCA” SHPK, me vlerë të ofertës 3.145.300 lekë.*
- 5. Operatori ekonomik “MURATI D”, me vlerë të ofertës 3.246.500 lekë.*
- 6. Operatori ekonomik “UNIVERS PROMOTIONS”, me vlerë të ofertës 3.188.310 lekë.*

*Ndër të tjera rezulton se KVO-ja ka vendosur që Operatori Ekonomik “MUCA”SHPK të mos kualifikohet, mbasi nuk ka përmbushur kërkesat e përcaktuara në DT.*

*Kundër vendimit to KVO-së ka ushtruar të drejtën e ankimit Operatorit Ekonomik “MUCA” SHPK, me anë të së cilës kërkon shfuqizimin e vendimit për skualifikim dhënë nga KVO-ja dhe kualifikimin e tij, duke paraqitur parashtrimet dhe provat.*

### **RRETHANAT E ÇËSHTJES OBJEKT SHQYRTIMI ADMINISTRATIV**

*Nga shqyrtimit i dokumentacionit të ndodhur në sistemin elektronik dhe ballafaqimit me shkaqet ku ankuesi mbështet pretendimet e tij rezulton se KVO-ja për skualifikimin e Operatorit Ekonomik “MUCA” SHPK ka argumentuar se nuk janë përmbushur kërkesat e përcaktuara në DT, e konkretisht:*

*- Në shtojcën 8 të DT, në kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 2.3 “Për kapacitetin teknik” ndërmjet të tjerave është kërkuar:*

*- Furnizimet e mëparshme, të ngjashme, në një vlerë jo më të ulët se 1.200.000 lekë, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit; Dëshmitë për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:*

*- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me ent publik, duhet të paraqesë Kontrate/Kontrata të nënshkruara të shoqëruara me vërtetim për realizimin e tyre dhe fatura tatimore të shitjes, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

*- Në rastin e përvojës së mëparshme, të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, ku të shënohen data, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

*KVO-ja bazuar në kërkesat e përcaktuara në DT, ka konkluduar se Operatorit Ekonomik “MUCA” SHPK nuk e përmbush kriterin e mësipërm, pasi faturat e paraqitura me sektorin privat, nuk janë furnizime për uniforma për Policinë Bashkiake ose të ngjashme me to, uniforma policie, uniforma ushtrie, uniforma zjarrfikëse etj., por furnizime për artikuj ndërtimi dhe industrial.*

*Ndërsa nga ankesa e ardhur nga Operatori Ekonomik “MUCA” SHPK, e administruar nga bashkia me nr. 1144/4 prot, datë 16.03.2021, në dokumentin standard me emërtimin “Formulari i ankesës për prokurimin pranë autoritetit kontraktor”, janë paraqitur argumentet me anë të së cilës hidhet poshtë vendimi i marrë nga KVO-ja, Autoriteti Kontraktor Bashkia Durrës për skualifikim, duke parashtruar argumentet dhe provat si më poshtë:*

*“... Së pari... Mendojmë se KVO-ja, nuk e ka vlerësuar me vëmendje dhe seriozitet ofertën tonë dhe dokumentet shoqëruese të saj, duke mos vërejtur artikujt dhe mallrat në përbërje të faturave të shitjes, të dërguara nga ana jonë si furnizime të ngjashme me artikujt e këtij tenderi.*

*Së dyti: ... Në DT, në shtojcën 8 “Kriteret e veçanta për kualifikim, pika 2.3: “Për kapacitetin teknik”, është kërkuar: “... Furnizimet e mëparshme, të ngjashme, në një vlerë jo më të ulët se 1.200.000 lekë, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit, dëshmitë për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:*

*Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me ent publik, duhet të paraqesë kontratë/kontrata të nënshkruara të shoqëruara me vërtetim për realizimin e tyre dhe fatura tatimore të shitjes, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar në sektorin privat, duhet të paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

Si dhe në shtojcën 10 të DT, artikujt përbërës të kësaj procedure janë:

<b>Nr.</b>	<b>Artikulli</b>	<b>Njësia</b>	<b>Sasia</b>	<b>Çmimi</b>	<b>Vlera</b>
1	Kostume	copë	38		
2	Xhiboks	copë	38		
3	Pantallona verore	copë	160		
4	Pantallona dimërore	copë	160		
5	Këmishë me mëngë të shkurtra	copë	160		
6	Këmishë me mëngë të gjata	copë	160		
7	Kollare	copë	80		
8	Kapele verore	copë	160		
9	Emblema kapele	copë	80		
10	Emblema krahu	copë	80		
11	Këpucë dimërore	copë	80		
12	Këpucë verore	copë	80		
13	Pulovra	copë	80		
14	Bluza	copë	160		
15	Rrip mesi	copë	38		
16	Pranga	copë	19		
17	Shkopinj Gome	copë	20		
18	Atlete Uniforme	copë	10		
19	Pelerina shiu	copë	10		
20	Kapele uniforme	copë	37		
21	Kostum ceremonial	copë	10		
22	Elektrik i thjeshte	copë	10		
23	Çizme Gome	copë	10		
	<b>Totali</b>				
	<b>TVSH 20%</b>				
	<b>TOTALI me TVSH</b>				

Në plotësim të kësaj kërkesë Operatori Ekonomik “MUCA” sh.p.k., ka paraqitur shumë fatura tatimore shitje, brenda të cilave, ka shumë artikuj të njëjtë ose të ngjashme me artikujt e preventivit të kësaj procedure, shuma e vlerave të shitjes është mbi 6.870.000 lekë, pra disa herë më e madhe se vlera 1.200.000 lekë, e përcaktuar në kërkesat për kualifikim.

**MË KONKRETISHT:**

<b>File</b>	<b>faq e</b>	<b>Nr. fat</b>	<b>data</b>	<b>artikulli</b>	<b>Nr. I artik ne fature</b>	<b>Vlera pa TVSh/leke</b>

8-TE NGJASHME etj-18-1	13	5779	09.03.2018	Çizme	2	4500
	14	5806	09.03.2018	Këpucë	21	11667
	14	5806	09.03.2018	Çizme	22	7392
	18	5904	19.03.2018	Dorashka	18,19,20,94	411 euro =542521e ke
	24	5929	21.03.2018	Ndriçues	3	570
	24	5929	21.03.2018	Çizme	6	5000
	25	6038	28.03.2018	Kominoshe	1	6667
	32	6091	31.03.2018	Elektrike dore	1	3300
	34	5939	21.03.2018	Elektrike dore	8	2200
	36	8036	24.04.2028	Kominoshe	10	12000
	38	9161	14.04.2018	Elektrike dore	14	3750
	41	9801	22.05.2018	Kominoshe	1	23333
	43	9964	31.05.2018	Kominoshe	23	6458
	45	9477	02.05.2018	Elektrike dore	1	3600
	47	9655	11.05.2018	Bluze dhe pantallona burrash	1,2,3	1735800
	48	362	25.06.2018	Këpucë verore	1,2	30000
	40	427	28.06.2018	Elektrike dore	3	25000
	52	761	20.07.2018	Elektrike dore	4	4333
9-TE NGJASHME etj-18-2	2	967	04.08.2018	Çizme	7	9120
	4	7905 6	14.08.2018	Elektrike dore	1	7250
	7	7981 7	29.09	Këpucë	33,34	19833
	11	7974 7	26.09	Kokore	1	4167
	13	7979 2	28.09	Kokore, Doreza, këpuce	1,2,7,8	14063
	14	7954 3	13.09	Elektrike dore	5	1275
	16	7957 7	14.09	Elektrike dore	1	4320
	18	7950 3	10.09	Elektrike dore	4	2000
	22	7824 6	30.11	Këpucë, doreza	15,16	15900

	24	7822 4	30.11	këpuce	6,7	10600
	26	7817 0	24.11	Kominoshe	7	9400
	30	7787 0	6.11	Kominoshe	11	4850
	34	7816 7	24.11	Jelekë, kokore	3,1	7458
	36	1187	14.11	Jelekë, bluza	1,2	750645
	37	7853 6	20.12	këpuce	1	14167
	39	7843 9	13.12	Ndriçues, Jelekë, këpuce	11,12,13,18, 22	47462
	41	7847 6	15.12	këpuce	1	10000
	43	7863 8	27.12	këpuce	1	12000
	44	7840 0	10.12	Ndriçues, kapele, kominoshe, rripa, doreza	1,2,3,5,11	66800
	45	7860 1	26.12	Doreza, kokore	1,2	23417
10-TE NGJASHME etj-19-1	7	154	17.01.2019	Veshje, kostume shiu	57,58	40833
	9	260	24.01	Kapele, doreza, jelekë, rripa, ndriçues, kostume shiu	1,2,3,4,5,10, 11	52160
	14	194	19.01	pelerina	3	10833
	16	304	28.01	rripa	10	15000
	18	362	31.01	Jelekë, doreza	4,5	34600
	19	224	22.01	pelerina	2	10833
	21	408	5.02	këpuce	10	18667
	34	4282 5	2.04	këpuce	6	46667
	36	5363	16.04	Jelekë, rripa, ndriçues, këpuce	2,4,5,6	20255
	37	5403	7.05	këpuce	1	30000
	39	2058 8	24.05	bluza	1,2	666668



	42	2082 9	8.06	<i>Këpucë, jelekë</i>	1,2,3	
	44	2099 5	19.06	<i>bluza</i>	1,2	750182
	50	2135 8	12.07	<i>këpuce</i>	1	24000
	51	2149 3	20.07	<i>bluza</i>	1	124630
	52	2150 6	23.07	<i>bluza</i>	1	123600
	58	2321 6	12.11	<i>këpuce</i>	1	29250
	61	2337 6	21.11	<i>Këpucë, mushama shiu</i>	1, 2	22458
<i>10-TE NGJASHME etj-19-2</i>	1	2321 1	22.11.2019	<i>kostume shiu</i>	9,10	35608
	3	2329 4	5.11	<i>Këmisha, bluza, Jelekë</i>	1,2,3,4	666981
	5	5943	31.12	<i>Çizme, këpuce, kapele</i>	1,2,10	45100
	42	2156 0	26.07	<i>këpuce</i>	9	16250
	53	2347 0	30.11	<i>këpuce</i>	1	12000
	55	2331 6	19.11	<i>Këpucë, doreza</i>	1,2	37167
	59	5852	14.11	<i>Çizme, kostume shiu</i>	9,11	15000
<i>12-TE NGJASHME etj-19-20</i>	8	6226	29.06.2020	<i>Çizme, kominoshe, këpuce</i>	3,4,5	51150
	9	2282	13.06	<i>Jelekë, doreza, kominoshe, këpucë</i>	1,2,3,5,6	65890
	16	4005	30.09	<i>këpuce</i>	1	30000
	17	4412	24.1	<i>këpuce</i>	3	24000
	21	3970	29.09	<i>Uniforma zjarrfikësi</i>	1,2,3,4	414000
	22	2486	03.01.2019	<i>përparëse</i>	1	28980
	23	5423	22.12.2020	<i>Jelekë, pelerina shiu për policinë</i>	4,5	103400

				<i>bashkiake</i>		
<i>13-TE NGJASHME etj-20-1</i>	<i>1</i>	<i>389</i>	<i>28.01.2020</i>	<i>Doreza, jelekë, këpuce</i>	<i>1,2,3</i>	<i>9200</i>
	<i>8</i>	<i>1786</i>	<i>18.05</i>	<i>këpuce</i>	<i>1</i>	<i>21333</i>
	<i>18</i>	<i>2895</i>	<i>18.07</i>	<i>Jelekë, Rripa</i>	<i>25,30,31,32</i>	<i>16365</i>
	<i>32</i>	<i>3589</i>	<i>4.09</i>	<i>Çizme, jelekë, kostume dhe pelerina shiu</i>	<i>9,12,13,14</i>	<i>38960</i>
	<i>38</i>	<i>4000</i>	<i>30.09</i>	<i>Çizme, kominoshe</i>	<i>1,3</i>	<i>12465</i>
<i>14-TE NGJASHME etj-20-2</i>	<i>5</i>	<i>4143</i>	<i>09.10.2020</i>	<i>pelerina</i>	<i>5,12</i>	<i>39083</i>
	<i>6</i>	<i>4412</i>	<i>24.1</i>	<i>këpuce</i>	<i>3</i>	<i>24000</i>
	<i>8</i>	<i>4279</i>	<i>16.1</i>	<i>Këpucë, Çizme, pelerina, Jelekë</i>	<i>1,2,3,4</i>	<i>40584</i>
	<i>10</i>	<i>4643</i>	<i>6.11</i>	<i>këpuce</i>	<i>1</i>	<i>31667</i>
	<i>14</i>	<i>5277</i>	<i>15.12</i>	<i>pelerina</i>	<i>1</i>	<i>75000</i>
<b><i>VLERA TOTALE</i></b>						<b><i>6 873 567</i></b>

*Po të vëmë re me kujdes brenda faturave të paraqitura, ka dhe uniforma për zjarrfikës, si dhe uniforma për policinë bashkiake Durrës.*

*Në bazë të LPP, kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës.*

*Ne nenin 27 “Kontratat e mallrave”, pika 4, të VKM se nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “... Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon ... dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit...”.*

*Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohet data, shuma dhe sasia e mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm faturat tatimore të shitjes, ku shënohen data dhe sasia e mallrave të furnizuara.*

*Sa më sipër, interpretimi i kontratave të paraqitura nga “MUCA” SHPK, nëse do të cilësohet si eksperiencë e ngjashme, duhet parë në raport me natyrën e mallrave dhe elementeve konkretë të realizimit të tyre, që autoriteti kontraktor synon të arrijë të kryejë pas lidhjes së kontratës me operatorin ekonomik të klasifikuar si të suksesshëm.*

*Nga tabela e mësipërme konstatohet qartë se me anë të dokumentacionit të mësipërm, të dorëzuar nga operatori ekonomik “MUCA” SHPK, ka dëshmuar se nga ana e tij janë bërë shitje të artikujve sipas preventivave në shtojcën 10 “Sasia dhe grafiku i lëvrimit”, të dokumenteve standarde të tenderit objekt ankimi. Referuar shitjeve të mësipërme me autoritete të ndryshme publike dhe privat; mallrat objekt prokurimi, të kërkuara nga autoriteti kontraktor, janë kryesisht veshje, me sasi të përkatëse për çdo produkt. Referuar objektit dhe preventivave të shitjeve të sipërcituar, rezulton se këto shitje janë të realizuara me sukses dhe në përputhje me afatet e përcaktuara.*

*Autoriteti kontraktor nuk mund të pretendojë zëra të ngjashëm për të gjitha zërat e pasqyruara në shtojcën 10 “Sasia dhe grafiku i lëvrimit”, të dokumenteve të procedurës, pasi një gjë e tillë të çon drejt përcaktimit të zërave të njëjtë të mallrave, në kundërshtim kjo me rregullat e prokurimit publik si më sipër cituar. Një përcaktim i tillë që në vetvete nënkupton eksperiencën të njëjta apo zëra të njëjtë të shërbimeve/punëve publike apo mallrave, bie në kundërshtim edhe me frymën dhe qëllimin e ligjit të përcaktuar në nenin 1 të tij, duke frenuar konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë dhe duke bërë një trajtim jo të barabartë dhe diskriminues të këtyre operatorëve ekonomik, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik.*

*Pra, referuar dëshmiave të eksperiencës së mëparshme, të dorëzuar, të realizuara, operatori ekonomik “MUCA” SHPK ka provuar se ka furnizuar mallra të cilat për nga natyra janë të ngjashme me objektin e procedurës së konkurrimit.*

*Në drejtim të dëshmisë së eksperiencës së mëparshme, të ngjashme me objektin e procedurës së konkurrimit, sipas ligjit, për autoritetin kontraktor, është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencë të mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit.*

*Sa më sipër, autoriteti kontraktor nuk duhet të gjykojë në mënyrë sipërfaqësore e formale, por të analizojë në themel dhe në mënyrë të arsyeshme e proporcionale eksperiencat e dokumentuara nga ofertuesit/kandidatët, në funksion të qëllimit dhe rrethanave faktike për të cilin vendosen kriteret e përcaktuara. Në rastin konkret, neni 46, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, është vërtetimi i eksperiencës së mëparshme të operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me anë të dokumentacionit të dorëzuar në SPE, Operatori Ekonomik “MUCA” SHPK ka vërtetuar se ka kryer me sukses furnizime të ngjashme në përputhje me përqindjen e kërkuar nga autoriteti kontraktor (40% të vlerës së fondit limit të kontratës së prokuruar).’*

*Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës, i ngritur me Urdhër nr. 178, datë 16.03.2021, bazuar në dokumentacionin e ndodhur në sistemin elektronik dhe ballafaqimit me shkaqet ku ankuesi ngre pretendimet e tij, gjykon se vendimi i KVO-së për skualifikimin e ofertuesit Operatori Ekonomik “MUCA” SHPK është i mbështetur në ligj e prova, ndaj kërkohet të lihet në fuqi.*

*Për vendimin e dhënë, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave u mbështet në dokumentet standarde (DT) të publikuara, me objekt: “Blerje uniforma për policinë bashkiake”.*

Rezulton se shkak për skualifikimin të ankuesit është mosparaqitja nga ky operator të kontratave të ngjashme e përcaktuar në shtojcën 8 të DT, në kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 2.3 “Për kapacitetin teknik” ndërmjet të tjerave është kërkuar:

- Furnizimet e mëparshme, të ngjashme, në një vlerë jo më të ulët se 1.200.000 lekë, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit; Dëshmitë për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me ent publik, duhet të paraqesë Kontratë/Kontrata të nënshkruara të shoqëruara me vërtetim për realizimin e tyre dhe fatura tatimore të shitjes, ku të shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara.

- Në rastin e përvojës së mëparshme, të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, ku të shënohen data, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara.

Nga aktet që ndodhen në sistemin elektronik, provat e paraqitura në ankim, nuk rezulton që Operatori Ekonomik “MUCA” SHPK, të ketë patur kontrata të nënshkruara me entet publike.

Gjithashtu Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave mori në shqyrtim dhe dokumentacionin (fature shitjeje) paraqitur në ankim nga ana e Operatorit Ekonomik “MUCA” SHPK, nga ku rezulton se ankuesi ka realizuar shitje të materialeve të ndërtimit, dhe në disa raste dhe rroba pune, por që nuk kanë lidhje me objektin e tenderimit me objekt: “Blerje uniforma për policinë bashkiake”, si më poshtë:

- Fature tatimore shitje, e kryer ndërmjet operatori ekonomik “MUCA” SHPK në cilësinë e shitësit dhe subjektit A+++ SHPK, me NIPT L82504004V, me nr. fature 5224, që mban datën 20.01.2018. Në këtë fature nuk janë pasqyruar artikuj që janë objekt tenderi.

Faturë tatimore shitje, e kryer ndërmjet operatori ekonomik “MUCA” SHPK në cilësinë e shitësit dhe subjektit “KU 20 ORUCI”, Kukës SHPK, me NIPT J88511208S, me faturë nr. 5207, që mban datën 22.1.2018. Në këtë faturë janë pasqyruar shitje artikujsh që u përkasin veshjeve të punëtorëve.

Fature tatimore shitje, e kryer ndërmjet operatorit ekonomik “MUCA” SHPK në cilësinë e shitësit dhe subjektit “STERKAJ” SHPK, Tiranë, me NIPT J68310708M, me faturë nr. 9499, që mban datën 24.2.2018, faturë e padeshifruar.

Faturë tatimore shitje e kryer ndërmjet operatorit ekonomik “MUCA” SHPK në cilësinë e shitësit dhe subjektit “FAKNORE” SHPK me NIPT K31404040G, me faturë nr. 3140, që mban datën 17.1.2018, ku në këtë faturë janë pasqyruar shitje këpucë pune.

Fature tatimore shitje e kryer ndërmjet operatorit ekonomik “MUCA” SHPK në cilësinë e shitësit dhe subjektit “DR03 Vullnet Aliqaj”, me NIPT K31528646G, me faturë nr.5065, që mban datën 12.01.2018. Në këtë faturë janë pasqyruar shitje kominoshe pune.

Faturë tatimore shitje, e kryer ndërmjet operatorit ekonomik “MUCA” SHPK në cilësinë e shitësit dhe subjektit “FR65 EAD” SHPK Fier, me NIPT K22706401H, me faturë që mban nr. 5064, datë 12.1.2018. S’ka asnjë artikull të publikuar për blerje uniformash për policinë bashkiake.

Faturë tatimore shitje e kryer ndërmjet operatorit ekonomik “MUCA” SHPK në cilësinë e shitësit dhe subjektit “FR 112 Jorgaq Xhaho”, Fier me NIPT K32713432D, me faturë që mban nr. 5064, datë 09.03.2018. Ska artikuj të publikuar për blerje uniformash për policinë bashkiake.

Faturë tatimore shitje e kryer ndërmjet operatorit ekonomik “MUCA” SHPK në cilësinë e shitësit dhe subjektit “PGOI Halil Dervishi”, Pogradec, me NIPT K33715699K, me faturë që mban nr. 58065064, datë 09.03.2018. Në këtë faturë janë pasqyruar vetëm blerje material këpucë dhe çizme pune.

Fature tatimore shitje e kryer ndërmjet operatorit ekonomik "MUCA" SHPK në cilësinë e shitësit dhe subjektit "Anila Haskaj", Shkodër, me NIPT L57107061D, me faturë që mban nr. 5929, datë 21.03. Në këtë faturë përfshihen shitje çizme pune.

Faturë tatimore shitje e kryer ndërmjet operatorit ekonomik "MUCA" SHPK në cilësinë e shitësit dhe subjektit "Vaniva" SHPK, Gjirokastrë, me NIPT L02602603L, me faturë që mban nr. 6038, datë 28.03.2018, blerje kominoshe.

Faturë tatimore shitje e kryer ndërmjet operatorit ekonomik "MUCA" SHPK në cilësinë e shitësit dhe subjektit "Auto Hysaj", Vorë, Tiranë, me NIPT L41910010J, me faturë që mban nr. 5724, datë 03.03.2018. Në këtë faturë përfshihen shitje kominoshe pune.

Fature tatimore shitje e kryer ndërmjet operatorit ekonomik "MUCA" SHPK në cilësinë e shitësit dhe subjektit Kukës "18 Amerika Group" SHPK, me NIPT L41910010J, me faturë që mban nr. 5860, datë 15.03.2018. Në këtë faturë s'ka asnjë artikull të publikuar për shitje uniformash të policisë bashkiake.

- Faturë tatimore shitje, e kryer ndërmjet operatorit ekonomik "MUCA" SHPK në cilësinë e shitësit dhe subjektit "FRO3 Roland Kamaraku", me NIPT K32718419B, me faturë që mban nr. 6091, datë 31.03.2018. Në këtë faturë s'ka asnjë artikull të publikuar për shitje uniformash të policisë bashkiake.

Faturë tatimore shitje, e kryer ndërmjet operatorit ekonomik "MUCA" SHPK në cilësinë e shitësit dhe subjektit "LU 19 Hajdar Arapi", Lushnje, me NIPT K34224417E, me faturë që mban nr. 6091, datë 21.03.2018. Në këtë faturë s'ka asnjë artikull të publikuar për blerje uniformash të policisë bashkiake.

Faturë tatimore shitje e kryer ndërmjet operatorit ekonomik "MUCA" SHPK në cilësinë e shitësit dhe subjektit "TR 0023 Besa Agro" SHPK Fushë-Krujë, me NIPT L41726002A, me faturë që mban nr. 8036, datë 24.04.2018. Në këtë faturë pasqyrohen blerje materiale që nuk kanë lidhje me uniformat e policisë bashkiake.

Faturë tatimore shitje, e kryer ndërmjet operatorit ekonomik "MUCA" SHPK në cilësinë e shitësit dhe subjektit "FR 130 Myrto Security" SHPK Fier, me NIPT K23333401N, me faturë që mban nr. 9161, datë

14.04.2018. Në këtë faturë s'ka asnjë artikull të publikuar për blerje uniformash të policisë bashkiake.

Faturë tatimore shitje e kryer ndërmjet operatorit ekonomik "MUCA" SHPK në cilësinë e shitësit dhe subjektit "Ervis Krimbi" Fier, me NIPT L03519401U, me faturë që mban nr. 9801, datë 22.05.2018. Në këtë faturë s'ka asnjë artikull të publikuar për blerje uniformash të policisë bashkiake.

Faturë tatimore shitje e kryer ndërmjet operatorit ekonomik "MUCA" SHPK në cilësinë e shitësit dhe subjektit "Kalia" SHPK Tiranë, me NIPT L41320036L, me faturë që mban nr. 9001, datë 22.05.2018. Në këtë faturë s'ka asnjë artikull të publikuar për blerje uniformash të policisë bashkiake.

Faturë tatimore shitje e kryer ndërmjet operatorit ekonomik "MUCA" SHPK në cilësinë e shitësit dhe subjektit "KR 02 Zamir Stojku" Fushë-Krujë, me NIPT K33709214V, me faturë që mban nr. 9964, datë 31.03.2018. Në këtë faturë është pasqyruar vetëm shitje kominoshe.

Faturë tatimore shitje e kryer ndërmjet operatorit ekonomik "MUCA" SHPK në cilësinë e shitësit dhe subjektit "Fatmir Kormaku", Tiranë, me NIPT K41529135N, me faturë që mban nr. 9655, datë 11.05.2018. Në këtë faturë s'ka asnjë artikull të publikuar për blerje uniformash të policisë bashkiake.

Faturë tatimore shitje, e kryer ndërmjet operatorit ekonomik "MUCA" SHPK në cilësinë e shitësit dhe subjektit ASC Tiranë, me NIPT K62115018L, me faturë që mban nr. 362, datë 5.6.2018. Në këtë faturë s'ka asnjë artikull të publikuar për blerje uniformash të policisë bashkiake.

*Faturë tatimore shitje, e kryer ndërmjet operatorit ekonomik "MUCA" SHPK në cilësinë e shitësit dhe subjektit "Sterkaj" SHPK, me NIPT J58310708M, me faturë që mban nr. 102, datë 7.6.2018. Në këtë faturë s'ka asnjë artikull të publikuar për blerje uniformash të policisë bashkiake.*

*Faturë tatimore shitje e kryer ndërmjet operatorit ekonomik "MUCA" SHPK në cilësinë e shitësit dhe subjektit "Metal Max", Podgorice. Nuk ka NIPT dhe mungon lista artikujve të shitur.*

*Faturë tatimore shitje, e kryer ndërmjet operatorit ekonomik "MUCA" SHPK në cilësinë e shitësit dhe subjektit "DR 03 Vullnet Deliaj", me NIPT U31528646G, me faturë që mban nr. 761, datë 20.7.2018. Në këtë faturë s'ka asnjë artikull të publikuar për blerje uniformash të policisë bashkiake.*

*Faturë tatimore shitje, e kryer ndërmjet operatorit ekonomik "MUCA" SHPK në cilësinë e shitësit dhe subjektit publik Bashkia Durrës, me NIPT K42006501R, me faturë që mban nr. 5423, datë 22.12.2020. Në këtë faturë s'ka asnjë artikull të publikuar për blerje uniformash të policisë bashkiake.*

*Faturë tatimore shitje, e kryer ndërmjet operatorit ekonomik "MUCA" SHPK në cilësinë e shitësit dhe subjektit publik Bashkia Libohovë, me faturë që mban nr. 3970, datë 29.9.2020. Në këtë faturë s'ka asnjë artikull të publikuar për blerje uniformash të policisë bashkiake.*

*Për sa trajtuam më lart, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës, konkludon se Operatori Ekonomik "MUCA" SHPK nuk plotëson kushtet e publikuara në DT, si për kontrata të ngjashme dhe për shitjet e kryera tek subjektet fizike. Faturat tatimore shitjeje të lëshuara për subjektet private nuk provon faktin se kemi të bëjmë me kontrata të ngjashme. Gjithashtu dhe artikujt si kominoshe pune, këpuce pune, çizme llastiku pune, jelek fosforeshent, pelerina shiu etj., nuk janë mallra të ngjashme me atë të publikuar në DT.*

*Për shqyrtimin e ankesës së Operatorit Ekonomik "MUCA" SHPK dhe marrjes së vendimit, Komisioni është bazuar në faturat e paraqitura në sistemin elektronik dhe jo në pasqyrën e paraqitur në ankim, në të cilën janë shënuar artikuj (zëra) që nuk përfshihen në faturat e shitjes së referuar nga ankuesi, si për rastin e faturave që mban nr. 5423, datë 22.12.2020 dhe nr. 3970, datë 29.9.2020.*

*Për sa trajtuam më lart, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës,*

#### **VENDOSI:**

*Lënien në fuqi të Vendimit të KVO-së.*

II.7. Në datën 30.03.2021 operatori ekonomik "MUCA" SHPK ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, me të njëjtat pretendime si ato të parashtruara pranë autoritetit kontraktor.

II.8. Në datën 11.03.2021, operatori ekonomik "Enea Masllavica" Person Fizik është njoftuar elektronikisht për vlerësimin e procedurës së prokurimit, si dhe skualifikimin e tij në procedurën e mësipërme të prokurimit me pretendimet si më poshtë vijon:

*"- B.O.E ENEA MASLLAVICA & VJOLLCA OSMANI me vlerë të ofertës 3.218.800 lekë, nuk ka përmbushur kërkesat për kualifikim të kërkuara në dokumentet e tenderit e konkretisht:*

- Në Shtojcën 8 të DT, në kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 2.3 “Për kapacitetin teknik” është kërkuar:

*Furnizimet e mëparshme, të ngjashme, në një vlerë jo më të ulët se 1.200.000 lekë, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit; Dëshmitë për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:*

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me ent publik, duhet të paraqesë Kontratë/Kontrata të nënshkruara të shoqëruara me vërtetim për realizimin e tyre dhe fatura tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

*B.O.E ENEA MASLLAVICA & VJOLLCA OSMANI nuk e përmbush kriterin e mësipërm, pasi furnizimet e ngjashme të paraqitura nëpërmjet faturave, janë me ent publik ku për të cilat, duheshin paraqitur Kontrata të nënshkruara të shoqëruara me vërtetim për realizimin e tyre, këto kontrata dhe vërtetime realizimi mungojnë.*

*KVO vendos që B.O.E ENEA MASLLAVICA & VJOLLCA OSMANI të mos kualifikohet.”.*

II.9. Operatori ekonomik “Enea Masllavica” Person Fizik, në datën 18.03.2021 ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij, sipas pretendimeve si më poshtë vijon:

*Ne jemi operator ekonomik që kemi marrë pjesë në këtë procedurë. Paraqesim ankesën tonë në lidhje me skualifikimin e padrejtë të bërë nga KVO.*

*B. O. E “ENEA MASLLAVICA & VJOLLCA OSMANI” me vlerë të ofertës 3.218.800 lekë, nuk përmbush kërkesat për kualifikim të kërkuara në dokumentet e tenderit e konkretisht: Në shtojcën 8 të DT, në kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 2.3 “Për kapacitetin teknik” është kërkuar: Furnizimet e mëparshme, të ngjashme, në një vlerë jo më të ulët se 1.200.000 lekë të realizuara gjatë 3(tre) viteve të fundit, Dëshmitë për furnizimet e mëparshme, të ngjashme duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:*

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me ent publik, duhet të paraqesë Kontratë&/Kontrata të nënshkruara të shoqëruara me vërtetim për realizimin e tyre dhe fatura tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqesë vetëm faturat tatimore të shitjes, ku shënohen, datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. B.O.E “ENEA MASLLAVICA & VJOLLCA OSMANI” nuk e përmbushin kriterin e mësipërm, pasi furnizimet e ngjashme të paraqitura nëpërmjet faturave, janë me ente publike ku për të cilat, duheshin paraqitur kontrata të nënshkruara të shoqëruara me vërtetim për realizimin e tyre, këto kontrata dhe vërtetime realizimi mungojnë. KVO vendosi që B.O.E “ENEA MASLLAVICA & VJOLLCA OSMANI” të mos kualifikohen.

*Ne e kundërshtojmë këtë skualifikim me arsyetimin e mëposhtëm:*

*Është e vërtetë që AK në DST ka kërkuar që OE e interesuara për këtë procedurë të paraqesin kontrata të realizuara me Entë Shtetërore.*

*Të gjitha faturat që ne kemi paraqitur si BOE në këtë procedurë janë fatura për punë të realizuara me subjekte shtetërore, por që janë të gjitha në procedura me blerje të vogël (BV). Në asnjë rast ne nuk na janë dhënë kontrata nga AK shtetërore, por na është kërkuar vetëm fatura e mallit objekt i BV. Në këto kushte ne nuk kemi patur çfarë kontratash të dorëzojmë. KVO mund të ishte interesuar pranë këtyre AK për të cilat ne kemi dorëzuar faturat dhe të pyeste nëse janë të vërteta këto fatura që ne kemi paraqitur.*

*Në këto kushte ne konsiderojmë të padrejtë skualifikimin.*

*- Në përfundim kërkojmë kualifikimin e BOE në këtë procedurë.*

II.10. Me shkresën nr.1144/10 prot, datë 30.03.2021, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik ankimes, duke mos e pranuar atë me pretendimet si më poshtë vijon:

*Nisur nga ankesa e paraqitur nga operatori ekonomik “Enea Masllavica” SHPK, me protokoll me nr.1144/5 Prot, datë 16.03.2021, për kontratën me objekt: “Blerje uniforma për policinë bashkiake”, ju sqarojmë si më poshtë:*

*Komisioni i ngritur me Urdhrin e zëvendëskryetarit të Bashkisë nr. 178, datë 16.03.2021, i përbërë nga z. A.p, z. S.F dhe znj. E.V, mbështetur në Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” dhe në Kreun X, neni 78, pika 5, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën e paraqitur nga Operatori Ekonomik “Enea Masllavica” SHPK.*

*Mbas shqyrtimit të dokumentacionit të ndodhur në sistemin elektronik dhe ballafaqimit me shkaqet ku ankuesi mbështet pretendimet e tij, vërehet se:*

*Autoriteti Kontraktor Bashkia Durrës (BD), në bazë të Urdhrit (KVO) nr.1144/2 prot., datë 16.02.2021, ka zhvilluar procedurën e prokurimit “E hapur” (prokurim elektronik), me objekt: “Blerje uniforma për policinë bashkiake”, me fond limit: 3.666.000 lekë (tre milion gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë) lekë, me fondet tona.*

*Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në procedurën për vlerësimin e ofertave, bazuar në metodën e paracaktuar të vlerësimit sipas Udhëzimit nr. 3, datë 05.05.2017 “Për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave në sistemin e prokurimit elektronik”, i ndryshuar, me objekt: “Blerje uniforma për policinë bashkiake”, me fond limit 3.666.000 leke (tre milion gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë) lekë, ka vlerësuar si më poshtë:*

*Oferta të kualifikuara: Nuk ka Oferta të kualifikuara:*

*1. Operatori ekonomik “ATLANTIK 3”, me vlerë të ofertës 3.184.020 lekë.*

*2. Operatori ekonomik “ENEA MASLLAVICA & VJOLLCA OSMANI”, me vlerë të ofertës 3.218.800 lekë.*

*3. Operatori ekonomik “GENTIAN SADIKU”, me vlerë të ofertës 3.441.200 lekë.*



4. Operatori ekonomik "MUCA" SHPK, me vlerë të ofertës 3.145.300 lekë.
5. Operatori ekonomik "MURATI D", me vlerë të ofertës 3.246.500 lekë.
6. Operatori ekonomik "UNIVERS PROMOTIONS", me vlerë të ofertës 3.188.310 lekë.

*Ndër të tjera rezulton se KVO-ja ka vendosur që Operatori Ekonomik "Enea Masllavica" SHPK të mos kualifikohet, mbasi nuk ka përmbushur kërkesat e përcaktuara në DT.*

*Kundër vendimit to KVO-së ka ushtruar të drejtën e ankimit Operatorit Ekonomik "Enea Masllavica" SHPK, me anë të së cilës kërkon shfuqizimin e vendimit për skualifikim dhënë nga KVO-ja dhe kualifikimin e tij, duke paraqitur parashtrimet dhe provat.*

#### **RRETHANAT E ÇËSHTJES OBJEKT SHQYRTIMI ADMINISTRATIV**

*Nga shqyrtimit i dokumentacionit të ndodhur në sistemin elektronik dhe ballafaqimit me shkaqet ku ankuesi mbështet pretendimet e tij rezulton se KVO-ja për skualifikimin e Operatorit Ekonomik "Enea Masllavica" SHPK ka argumentuar se nuk janë përmbushur kërkesat e përcaktuara në DT, e konkretisht:*

*- Në shtojcën 8 të DT, në kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 2.3 "Për kapacitetin teknik" ndërmjet të tjerave është kërkuar:*

*- Furnizimet e mëparshme, të ngjashme, në një vlerë jo më të ulët se 1.200.000 lekë, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit; Dëshmitë për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:*

*- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me ent publik, duhet të paraqesë Kontrate/Kontrata të nënshkruara të shoqëruara me vërtetim për realizimin e tyre dhe fatura tatimore të shitjes, ku të shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara.*

*- Në rastin e përvojës së mëparshme, të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, ku të shënohen data, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara.*

*KVO-ja bazuar në kërkesat e përcaktuara në DT, ka konkluduar se Operatorit Ekonomik "Enea Masllavica" SHPK nuk e përmbush kriterin e përcaktuar dhe të publikuar ku është kërkuar "... Furnizime të mëparshme, të ngjashme, në një vlerë jo më të ulët se 1.200.000 lekë, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit; Dëshmitë për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacion. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me ent publik, duhet të paraqesë Kontratë/Kontrata të nënshkruara të shoqëruara me vërtetim për realizimin e tyre dhe fatura tatimore të shitjes, ku të shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara...".*

*Ndërsa nga ankesa e ardhur nga Operatori Ekonomik "Enea Masllavica" SHPK, e administruar nga bashkia me nr. 1144/5 prot, datë 18.03.2021, në dokumentin standard me emërtimin "Formulari i ankesës për prokurimin pranë autoritetit kontraktor", janë paraqitur argumentet me anë të së cilës hidhet poshtë vendimi i marrë nga KVO-ja, Autoriteti Kontraktor Bashkia Durrës për skualifikim, duke parashtruar argumentet dhe provat si më poshtë:*

*"... Të gjitha faturat që ne kemi paraqitur në këtë procedurë janë fatura për punë të realizuara me subjekte shtetërore, por që janë të gjitha me procedurë me blerje të vogla. Në asnjë rast ne nuk na janë*

*dhënë kontrata nga AK shtetërore, por na është kërkuar vetëm fatura e mallit për blerjet e vogla. Në këto kushte ne nuk kemi patur kontrata që të dorëzojmë.. KVO-ja mund të ishte interesuar pranë këtyre AK për të cilat ne kemi dorëzuar faturat dhe të pyeste nëse janë të vërteta këto fatura që ne kemi paraqitur. Në këto kushte ne e konsiderojmë të padrejtë skualifikimin...”*

*Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës, i ngritur me Urdhër nr. 185, datë 19.03.2021, bazuar në dokumentacionin e ndodhur në sistemin elektronik dhe ballafaqimit me shkaqet ku ankuesi ngre pretendimet e tij, gjykon se vendimi i KVO-së për skualifikimin e ofertuesit Operatori Ekonomik “Enea Masllavica” SHPK është i mbështetur në ligj e prova, ndaj kërkohet të lihet në fuqi.*

*Për vendimin e dhënë, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave u mbështet në dokumentet standarde (DT) të publikuara, me objekt: “Blerje uniforma për policinë bashkiake”.*

*Rezulton se shkak për skualifikimin të ankuesit është mosparaqitja nga ky operator të kontratave të ngjashme e përcaktuar në shtojcën 8 të DT, në kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 2.3 “Për kapacitetin teknik” ndërmjet të tjerave është kërkuar:*

*- Furnizimet e mëparshme, të ngjashme, në një vlerë jo më të ulët se 1.200.000 lekë, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit; Dëshmitë për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:*

*- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me ent publik, duhet të paraqesë Kontratë/Kontrata të nënshkruara të shoqëruara me vërtetim për realizimin e tyre dhe fatura tatimore të shitjes, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.*

*KVO-ja ka arsyetuar se operatorit ekonomik “Enea Masllavica” SHPK nuk e përmbush kriterin e mësipërm, pasi furnizimet e ngjashme të paraqitura nëpërmjet faturave, janë me ent publik ku për të cilat, duheshin paraqitur Kontrata të nënshkruara të shoqëruara me vërtetim për realizimin e tyre, këto kontrata dhe vërtetime realizimi mungojnë. Ndaj ka vendosur që “B.O.E Enea Masllavica & Vjollca Osmani” të mos kualifikohet.*

*Nga aktet që ndodhen në sistemin elektronik, provat e paraqitura në ankim, nuk rezulton që Operatori Ekonomik “Enea Masllavica” SHPK, të ketë patur kontrata të nënshkruara me entet publike e shoqëruar me vërtetim për realizimin e tyre. Gjithashtu Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave mori në shqyrtim dhe dokumentacionin (faturë shitje) paraqitur në ankim nga ana e Operatorit Ekonomik “Enea Masllavica” SHPK, nga ku rezulton se ankuesi ka realizuar shitje të artikujve që janë të ngjashme me ato të publikuar në APP, si më poshtë:*

*- Faturë tatimore shitje, e kryer ndërmjet operatori ekonomik “Enea Masllavica” SHPK në cilësinë e shitësit dhe entit publik Bashkia Korçë, me NIPT K54105075C, me nr. fature 014, që mban datën 16.10.2020. Në këtë faturë janë pasqyruar pjesërisht artikuj që janë objekt tenderi.*

*- Faturë tatimore shitje, e kryer ndërmjet operatori ekonomik “Enea Masllavica” SHPK në cilësinë e shitësit dhe entit publik Bashkia Vorë, me NIPT K51713032C, me nr. fature 002, që mban datën 16.01.2020. Në këtë faturë janë pasqyruar pjesërisht artikuj që janë objekt tenderi.*

*Faturë tatimore shitje, e kryer ndërmjet operatori ekonomik “Enea Masllavica” SHPK në cilësinë e shitësit dhe entit publik Shtëpia e të Moshuarve Tiranë, me NIPT K51731014 C, me nr. fature 84, që mban datën 11.12.2020. Në këtë faturë janë pasqyruar pjesërisht artikuj që janë objekt tenderi.*

*Faturë tatimore shitje, e kryer ndërmjet operatori ekonomik “Enea Masllavica” SHPK në cilësinë e shitësit dhe entit publik Qendra Kombëtare Pritëse e viktimave të trafikimit, me NIPT K51731015K, me nr. fature 81, që mban datën 11.12.2020. Në këtë faturë janë pasqyruar pjesërisht artikuj që janë objekt tenderi.*

*Faturë tatimore shitje, e kryer ndërmjet operatori ekonomik “Enea Masllavica” SHPK në cilësinë e shitësit dhe entit publik Universiteti Aleksandër Xhuvani Elbasan, me NIPT K52905217I, me nr. faturë 021, që mban datën 07.12.2020. Në këtë faturë janë pasqyruar pjesërisht artikuj që janë objekt tenderi.*

*Faturë tatimore shitje, e kryer ndërmjet operatori ekonomik “Enea Masllavica” SHPK në cilësinë e shitësit dhe entit publik Bashkia Patos, me NIPT K529034190 C, me nr. fature 90, që mban datën 18.02.2020. Në këtë faturë janë pasqyruar pjesërisht artikuj që janë objekt tenderi.*

*Për sa trajtuam më lart, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës, konkludon se Operatori Ekonomik “Enea Masllavica” SHPK ka shitur artikuj ku përfshihen dhe zërat e përcaktuar në DT, me entet publik.*

*Bazuar në kriteret e kualifikimit, të publikuara rezulton se Operatori Ekonomik “Enea Masllavica” SHPK, për shitjet e kryera enteve publike, përveç faturave të shitjes, duhet të kishte dhe kontratë të nënshkruara nga dy palët, shitësi dhe blerësi të shoqëruar me vërtetim për realizimin e tyre.*

*Për sa trajtuam më lart, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës,*

#### **VENDOSI:**

*Lënien në fuqi të Vendimit të KVO-së.*

II.11. Në datën 01.04.2021 operatori ekonomik “Enea Masllavica” Person Fizik ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, me të njëjtat pretendime si ato të parashtruara pranë autoritetit kontraktor.

II.12. Nëpërmjet shkresës nr. 1144/16 prot, datë 12.04.2021, nr. 7189/1 prot, protokolluar me tonën në datë 13.04.2021, me objekt “Dërgim Informacioni për Vendimin nr. 503/I” është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesave të operatorëve ekonomikë ankimues.

### **III**

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

#### **Arsyeton**

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “MUCA” SHPK, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së paraqitur prej tij, me arsyen se: “- O.E MUCA me vlerë të ofertës 3.145.300 lekë, nuk ka përmbushur kërkesat për kualifikim të kërkuara në dokumentet e tenderit e konkretisht:

- Në Shtojcën 8 të DT, në kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 2.3 “Për kapacitetin teknik” është kërkuar: Furnizimet e mëparshme, të ngjashme, në një vlerë jo më të ulët se 1.200.000 lekë, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit; Dëshmitë për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me ent publik, duhet të paraqesë Kontratë/Kontrata të nënshkruara të shoqëruara me vërtetim për realizimin e tyre dhe fatura tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

O.E MUCA nuk e përmbush kriterin e mësipërm, pasi faturat e paraqitura me sektorin privat, nuk janë furnizime për uniforma për Policinë Bashkiake ose të ngjashme me to, ose p.sh. uniforma policie, uniforma ushtrie, uniforma zjarrëfikse e të tjera si këto, por furnizime për artikuj ndërtimi dhe industrial. KVO vendos që O.E MUCA të mos kualifikohet.” , Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentet e tenderit të modifikuara, shtojca 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 2.3, autoriteti kontraktor ka parashikuar se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

“Furnizimet e mëparshme, të ngjashme, në një vlerë jo më të ulët se **1.200.000** lekë, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit;

Dëshmitë për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me ent publik, duhet të paraqesë Kontratë/Kontrata të nënshkruara të shoqëruara me vërtetim për realizimin e tyre dhe fatura tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”.

Ndërsa në dokumentet e tenderit, shtojca 10 “Sasia dhe grafiku i lëvrimit”, autoriteti kontraktor ka publikuar natyrën e mallrave objekt prokurimi si më poshtë:

**Shtojca 10**

**[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]**

**SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT**

Nr.	Artikulli	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
1	Kostume	copë	38		
2	Xhiboks	copë	38		
3	Pantallona verore	copë	160		
4	Pantallona dimërore	copë	160		

5	<i>Këmishë me mëngë të shkurtra</i>	<i>copë</i>	<i>160</i>		
6	<i>Këmishë me mëngë të gjata</i>	<i>copë</i>	<i>160</i>		
7	<i>Kollare</i>	<i>copë</i>	<i>80</i>		
8	<i>Kapele verore</i>	<i>copë</i>	<i>160</i>		
9	<i>Emblema kapele</i>	<i>copë</i>	<i>80</i>		
10	<i>Emblema krah</i>	<i>copë</i>	<i>80</i>		
11	<i>Këpucë dimërore</i>	<i>copë</i>	<i>80</i>		
12	<i>Këpucë verore</i>	<i>copë</i>	<i>80</i>		
13	<i>Pulovra</i>	<i>copë</i>	<i>80</i>		
14	<i>Bluza</i>	<i>copë</i>	<i>160</i>		
15	<i>Rrip mesi</i>	<i>copë</i>	<i>38</i>		
16	<i>Pranga</i>	<i>copë</i>	<i>19</i>		
17	<i>Shkopinj Gome</i>	<i>copë</i>	<i>20</i>		
18	<i>Atlete Uniforme</i>	<i>copë</i>	<i>10</i>		
19	<i>Pelerina shiu</i>	<i>copë</i>	<i>10</i>		
20	<i>Kapele uniforme</i>	<i>copë</i>	<i>37</i>		
21	<i>Kostum ceremonial</i>	<i>copë</i>	<i>10</i>		
22	<i>Elektrik i thjeshtë</i>	<i>copë</i>	<i>10</i>		
23	<i>Çizme Gome</i>	<i>copë</i>	<i>10</i>		
	<b><i>Totali</i></b>				
	<b><i>TVSH 20%</i></b>				
	<b><i>TOTALI me TVSH</i></b>				

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike, rezulton se operatori ekonomik ankimues, në përmbushje të kriterit të lartpërmendur ka paraqitur dokumentacionin e mëposhtëm:

- *Faturën tatimore të shitjes me numër serial 60239655, datë 11.05.2018, për artikullin “Pantallona burrash” me vlerë 186000 lekë (pa-TVSH).*
- *Faturën tatimore të shitjes me numër serial 69501594, datë 05.11.2019, për artikullin “Këmishë burrash sintetike” me vlerë 62200 lekë (pa-TVSH).*
- *Faturën tatimore të shitjes me numër serial 65778400, datë 20.12.2018, për artikullin “Kapele punëtori” me vlerë 8000 lekë (pa-TVSH).*
- *Faturën tatimore të shitjes me numër serial 65778920, datë 24.01.2018, për artikullin “Kapele punëtori” me vlerë 11200 lekë (pa-TVSH).*
- *Faturën tatimore të shitjes me numër serial 82690643, datë 31.12.2019, për artikullin “Kapele punëtori” me vlerë 5500 lekë (pa-TVSH).*
- *Faturën tatimore të shitjes me numër serial 77992292, datë 25.01.2020, për artikullin “Këpucë pune” me vlerë 534 lekë (pa-TVSH).*

- Faturën tatimore të shitjes me numër serial 82690926, datë 29.06.2020, për artikullin “Këpucë pune” me vlerë 21600 lekë (pa-TVSH).
- Faturën tatimore të shitjes me numër serial 86603772, datë 13.06.2020, për artikullin “Këpucë pune” me vlerë 41250 lekë (pa-TVSH).
- Faturën tatimore të shitjes me numër serial 91342595, datë 30.09.2020, për artikullin “Këpucë pune” me vlerë 30000 lekë (pa-TVSH).
- Faturën tatimore të shitjes me numër serial 93758802, datë 24.10.2020, për artikullin “Këpucë pune” me vlerë 24000 lekë (pa-TVSH).
- Faturën tatimore të shitjes me numër serial 82690828, datë 18.05.2020, për artikullin “Këpucë pune” me vlerë 14450 lekë (pa-TVSH).
- Faturën tatimore të shitjes me numër serial 60240362, datë 05.06.2018, për artikullin “Këpucë verore” me vlerë 30000 lekë (pa-TVSH).
- Faturën tatimore të shitjes me numër serial 69501931, datë 23.11.2019, për artikullin “Triko” me vlerë 1500 lekë (pa-TVSH).
- Faturën tatimore të shitjes me numër serial 60241187, datë 14.11.2018, për artikullin “Jelek burrash” me vlerë 201275 lekë (pa-TVSH).
- Faturën tatimore të shitjes me numër serial 60239655, datë 11.05.2018, për artikullin “Bluze burrash” me vlerë 1549800 lekë (pa-TVSH).
- Faturën tatimore të shitjes me numër serial 60241187, datë 14.11.2018, për artikullin “Bluze burrash” me vlerë 549370 lekë (pa-TVSH).
- Faturën tatimore të shitjes me numër serial 75020995, datë 19.06.2019, për artikullin “Bluze sintetike” me vlerë 36050 lekë (pa-TVSH).
- Faturën tatimore të shitjes me numër serial 75020588, datë 24.05.2019, për artikullin “Bluze sintetike burrash” me vlerë 257500 lekë (pa-TVSH).
- Faturën tatimore të shitjes me numër serial 75021493, datë 20.07.2019, për artikullin “Bluze sintetike burrash” me vlerë 124630 lekë (pa-TVSH).
- Faturën tatimore të shitjes me numër serial 65778854, datë 19.01.2019, për artikullin “Pelerina shiu” me vlerë 10833 lekë (pa-TVSH).
- Faturën tatimore të shitjes me numër serial 93759613, datë 22.12.2020, për artikullin “Pelerina shiu” me vlerë 57200 lekë (pa-TVSH).
- Faturën tatimore të shitjes me numër serial 91342179, datë 04.09.2020, për artikullin “Pelerina shiu” me vlerë 14400 lekë (pa-TVSH).
- Faturën tatimore të shitjes me numër serial 91342869, datë 16.10.2020, për artikullin “Pelerina shiu” me vlerë 9334 lekë (pa-TVSH).
- Faturën tatimore të shitjes me numër serial 93759417, datë 15.12.2020, për artikullin “Pelerina shiu” me vlerë 75000 lekë (pa-TVSH).
- Faturën tatimore të shitjes me numër serial 65778400, datë 10.12.2018, për artikullin “Kapele punëtori” me vlerë 8000 lekë (pa-TVSH).
- Faturën tatimore të shitjes me numër serial 65778920, datë 24.01.2018, për artikullin “Kapele punëtori” me vlerë 11200 lekë (pa-TVSH).

- Faturën tatimore të shitjes me numër serial 82690643, datë 31.12.2019, për artikullin “Kapele punëtori” me vlerë 5500 lekë (pa-TVSH).
- Faturën tatimore të shitjes me numër serial 60238941, datë 31.03.18, për artikullin “Elektrik dore blu” me vlerë 3300 lekë (pa-TVSH).
- Faturën tatimore të shitjes me numër serial 60238789, datë 21.03.18, për artikullin “Elektrik dore kuq&blu” me vlerë 2200 lekë (pa-TVSH).
- Faturën tatimore të shitjes me numër serial 60239161, datë 14.04.18, për artikullin “Elektrik dore kuq&blu” me vlerë 3750 lekë (pa-TVSH).
- Faturën tatimore të shitjes me numër serial 60239161, datë 14.04.18, për artikullin “Elektrik dore kuq&blu” me vlerë 3750 lekë (pa-TVSH).
- Faturën tatimore të shitjes me numër serial 60239477, datë 02.05.18, për artikullin “Elektrik dore” me vlerë 3600 lekë (pa-TVSH).
- Faturën tatimore të shitjes me numër serial 60240427, datë 28.06.18, për artikullin “Elektrik dore” me vlerë 2500 lekë (pa-TVSH).
- Faturën tatimore të shitjes me numër serial 60240761, datë 20.07.18, për artikullin “Elektrik dore” me vlerë 4330 lekë (pa-TVSH).
- Faturën tatimore të shitjes me numër serial 65779056, datë 14.08.18, për artikullin “Elektrik dore” me vlerë 7250 lekë (pa-TVSH).
- Faturën tatimore të shitjes me numër serial 65779543, datë 13.09.18, për artikullin “Elektrik dore” me vlerë 1275 lekë (pa-TVSH).
- Faturën tatimore të shitjes me numër serial 65779577, datë 14.09.18, për artikullin “Elektrik” me vlerë 4320 lekë (pa-TVSH).
- Faturën tatimore të shitjes me numër serial 60238629, datë 09.03.2018, për artikullin “Çizme pune të shkurtra” me vlerë 4500 lekë (pa-TVSH).
- Faturën tatimore të shitjes me numër serial 60238656, datë 09.03.2018, për artikullin “Çizme pune të shkurtra” me vlerë 7392 lekë (pa-TVSH).
- Faturën tatimore të shitjes me numër serial 60238779, datë 21.03.2018, për artikullin “Çizme pune” me vlerë 5000 lekë (pa-TVSH).
- Faturën tatimore të shitjes me numër serial 60240967, datë 04.08.2018, për artikullin “Çizme pune” me vlerë 9120 lekë (pa-TVSH).
- Faturën tatimore të shitjes me numër serial 82690643, datë 31.12.2019, për artikullin “Çizme pune të shkurtra” me vlerë 2600 lekë (pa-TVSH).
- Faturën tatimore të shitjes me numër serial 82690552, datë 14.11.2019, për artikullin “Çizme pune të shkurtra” me vlerë 7200 lekë (pa-TVSH).
- Faturën tatimore të shitjes me numër serial 82690926, datë 29.06.2020, për artikullin “Çizme pune të shkurtra” me vlerë 14550 lekë (pa-TVSH).
- Faturën tatimore të shitjes me numër serial 91342179, datë 04.09.2020, për artikullin “Çizme pune të shkurtra” me vlerë 7875 lekë (pa-TVSH).
- Faturën tatimore të shitjes me numër serial 91342590, datë 30.09.2020, për artikullin “Çizme pune të shkurtra” me vlerë 11025 lekë (pa-TVSH).

- *Faturën tatimore të shitjes me numër serial 91342636, datë 02.10.2020, për artikullin “Çizme pune të shkurtra” me vlerë 5250 lekë (pa-TVSH).*

III.1.3. Në nenin 46 pika 1 gërma “a” dhe gërma “b” e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik i ndryshuar parashikohet se: “[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese:

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit... .”

III.1.4. Në nenin 27 “Kontratat e Mallrave” pika 4, të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit.

*Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit. Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

*Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”.*

III.1.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.6. Sa më sipër, autoriteti kontraktor nuk duhet të gjykojë në mënyrë sipërfaqësore e formale, por të analizojë në themel dhe në mënyrë të arsyeshme e proporcionale eksperiencat e dokumentuara nga ofertuesit/kandidatët, në funksion të qëllimit dhe rrethanave faktike për të cilin vendosen kriteret e përcaktuara. Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik thekson se interpretimi i faturave të shitjes të paraqitura nga operatori ekonomik ankimes nëse do të cilësohet si eksperiencë e ngjashme duhet parë në raport me natyrën e mallrave objekt prokurimi (zërat e preventivit) që autoriteti kontraktor synon të



arrijë të kryejë në cilësinë e “investitorit”, pas lidhjes së kontratës me operatorin ekonomik të klasifikuar të suksesshëm.

III.1.7. Referuar arsyes së skualifikimit të dhënë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave se: “- Në rastin e përvojës së mëparshme, të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, ku të shënohen data, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. KVO-ja bazuar në kërkesat e përcaktuara në DT, ka konkluduar se Operatorit Ekonomik “MUCA” SHPK nuk e përmbush kriterin e mësipërm, pasi faturat e paraqitura me sektorin privat, nuk janë furnizime për uniforma për Policinë Bashkiake ose të ngjashme me to, uniforma policie, uniforma ushtrie, uniforma zjarrfikëse etj., por furnizime për artikuj ndërtimi dhe industrial.”, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se me dokumentacionin e paraqitur ankimesi vërteton se ka kryer furnizime të ngjashme me objektin e prokurimit, duke dëshmuar të gjitha kapacitetet për të kryer furnizimin me mallrat e kërkuara nga ana e autoritetit kontraktor. Autoriteti kontraktor nuk mund të pretendojë zëra të ngjashëm për të gjithë zërat e preventivit, pasi një gjë e tillë të çon drejt përcaktimit të zërave të njëjtë të furnizimit me mallra, në kundërshtim kjo me rregullat e prokurimit publik si më sipër cituar. Një përcaktim i tillë që në vetvete nënkupton eksperiencë të njëjta apo zëra të njëjtë të mallrave, bie në kundërshtim edhe me vetë frymën dhe qëllimin e ligjit të përcaktuara në nenin 1 të tij, duke frenuar konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomik dhe duke bërë një trajtim jo të barabartë dhe diskriminues të këtyre operatorëve ekonomik pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik. Sa më sipër analizuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se ankimesi ka kryer furnizime të ngjashme me kontratën objekt ankimi, duke treguar kapacitetet e këtij operatori për të kryer furnizimin me mallrat e kërkuara nga ana e autoritetit kontraktor. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankimesi e ka përmbushur kriterin e kualifikimit duke vërtetuar kështu se disponon kapacitetet në lidhje me eksperiencat e mëparshme të kërkuara nga autoriteti kontraktor për të realizuar këtë kontratë.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimese qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Enea Masllavica” Person Fizik, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së paraqitur prej tij, me arsyen se: B.O.E “ENEAMASLLAVICA & VJOLLCA OSMANI” me vlerë të ofertës 3.218.800 lekë, nuk përmbush kërkesat për kualifikim të kërkuara në dokumentet e tenderit e konkretisht: Në shtojcën 8 të DT, në kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 2.3 “Për kapacitetin teknik” është kërkuar: Furnizimet e mëparshme, të ngjashme, në një vlerë jo më të ulët se 1.200.000 lekë të realizuara gjatë 3(tre) viteve të fundit, Dëshmitë për furnizimet e mëparshme, të ngjashme duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me ent publik, duhet të paraqesë Kontratë&/Kontrata të nënshkruara të shoqëruara me vërtetim për realizimin e tyre dhe fatura tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqesë vetëm faturat tatimore të shitjes, ku shënohen, datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. B.O.E “ENEAMASLLAVICA & VJOLLCA OSMANI” nuk e përmbushin kriterin e mësipërm, pasi furnizimet e ngjashme të paraqitura nëpërmjet faturave, janë me ente publike ku për të cilat, duheshin paraqitur kontrata të nënshkruara të shoqëruara me vërtetim për realizimin e tyre, këto kontrata dhe vërtetime

*realizimi mungojnë. KVO vendosi që B.O.E “ENEA MASLLAVICA & VJOLLCA OSMANI” të mos kualifikohen”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.2.1. Në dokumentet e tenderit të modifikuara, shtojca 8 *“Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 2.3, autoriteti kontraktor ka parashikuar se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:*

*“Furnizimet e mëparshme, të ngjashme, në një vlerë jo më të ulët se 1.200.000 lekë, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit;*

*Dëshmitë për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:*

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me ent publik, duhet të paraqesë Kontratë/Kontrata të nënshkruara të shoqëruara me vërtetim për realizimin e tyre dhe fatura tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”.*

III.2.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike, rezulton se operatori ekonomik ankimues *“Enea Masllavica”* Person Fizik ka ofertuar si përfaqësues i bashkimit të shoqërive *“Enea Masllavica Person Fizik & Vjollca Osmani Person Fizik”* krijuar me kontratën noteriale të bashkëpunimit nr. 1016 rep, datë 04.03.2021, ku shoqëria *“Enea Masllavica”* Person Fizik ka marrë përsipër që të furnizojë 72% të secilit nga zërat e preventivit, ndërsa shoqëria *“Vjollca Osmani”* Person Fizik ka marrë përsipër që të furnizojë 28% të secilit nga zërat e preventivit, ndërkohë që në përmbushje të kriterit të lartpërmendur ka paraqitur dokumentacionin e mëposhtëm:

- Faturën tatimore me numër serial 93378284, datë 11.12.2020, të lëshuar nga shoqëria *“Vjollca Osmani”* Person Fizik dhe blerës Shtëpia e të Moshuarve Tiranë, me objekt shitje veshje dhe vlerë 98000 lekë (pa-TVSH).
- Faturën tatimore me numër serial 93378281, datë 11.12.2020, të lëshuar nga shoqëria *“Vjollca Osmani”* Person Fizik dhe blerës Qendra Kombëtare Pritëse e Viktimave të Trafikimit Tiranë, me objekt shitje veshje anticovid dhe vlerë 99720 lekë (pa-TVSH).
- Faturën tatimore me numër serial 70347761, datë 09.09.2020, të lëshuar nga shoqëria *“Enea Masllavica”* Person Fizik dhe blerës Bashkia Pustec, me objekt shitje xhupa, xhaketa, kapele, kollare, emblemë, këpucë, kostum, pulovër, bluze dhe vlerë 248000 lekë (pa-TVSH).
- Faturën tatimore me numër serial 70347752, datë 13.01.2020, të lëshuar nga shoqëria *“Enea Masllavica”* Person Fizik dhe blerës Bashkia Vorë, me objekt shitje kostum shërbimi, xhiboks, kambale, bluza polo, kapele, stema, grada dhe vlerë 284600 lekë (pa-TVSH).
- Faturën tatimore me numër serial 70347757, datë 29.06.2020, të lëshuar nga shoqëria *“Enea Masllavica”* Person Fizik dhe blerës SHISH, me objekt shitje logo, numra identifikimi dhe vlerë 306000 lekë (pa-TVSH).
- Faturën tatimore me numër serial 70347771, datë 07.12.2020, të lëshuar nga shoqëria *“Enea Masllavica”* Person Fizik dhe blerës Universiteti *“Aleksandër Xhuvani”* Elbasan, me objekt

shitje përparëse sanitare, pantallona, pantofla, përparëse dhe kapele ceremonie diplomimi dhe vlerë 478000 lekë (pa-TVSH).

- Faturën tatimore me numër serial 83332499, datë 18.02.2020, të lëshuar nga shoqëria “Vjollca Osmani” Person Fizik dhe blerës Bashkia Patos, me objekt shitje xhakete, pantallona, këmbisha, kapele, këpucë, grada, stema, xhupa dhe vlerë 150000 lekë (pa-TVSH).
- Faturën tatimore me numër serial 70347764, datë 16.10.2020, të lëshuar nga shoqëria “Enea Masllavica” Person Fizik dhe blerës Bashkia Korçë, me objekt shitje xhupa dimërorë për punonjësit e [parkimit dhe vlerë 62000 lekë (pa-TVSH).

III.2.3. Në nenin 46 pika 1 gërma “a” dhe gërma “b” e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik i ndryshuar parashikohet se: *“[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese:*

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit... ”*

III.2.4. Në nenin 27 “Kontratat e Mallrave” pika 4, të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se: *“Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit.*

*Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit. Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.*

*Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.”*

Ndërsa në nenin 40 “Procedura e prokurimit me vlerë të vogël” pika 7, të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se: *“Pagesa për prokurimet me vlerë të vogël bëhet sipas legjislacionit tatimor në fuqi. Në çdo rast, faturat e mallrave apo të shërbimeve duhet të jenë të rregullta sipas legjislacionit në fuqi, si dhe të nënshkruhen nga anëtarët e komisionit. Faturat e lëshuara kanë vlerën e kontratës së lidhur, kur palët nuk kanë nënshkruar një të tillë.”*

III.2.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë,

përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.6. Sa më sipër, autoriteti kontraktor nuk duhet të gjykojë në mënyrë sipërfaqësore e formale, por të analizojë në themel dhe në mënyrë të arsyeshme e proporcionale eksperiencat e dokumentuara nga ofertuesit/kandidatët, në funksion të qëllimit dhe rrethanave faktike për të cilin vendosen kriteret e përcaktuara. Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik thekson se interpretimi i faturave të shitjes të paraqitura nga operatori ekonomik ankimues me ente publike dhe të pashoqëruara me kontratën përkatëse të lidhur me këtë ent publik, nëse do të cilësohet si eksperiencë e ngjashme duhet parë në raport me parashikimin ligjor të nenit 40, pika 7, të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

III.1.7. Referuar arsyes së skualifikimit të dhënë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave se: *B.O.E “Enea Masllavica & Vjosa Osmani” nuk e përmbushin kriterin e mësipërm, pasi furnizimet e ngjashme të paraqitura nëpërmjet faturave, janë me ente publike ku për të cilat, duheshin paraqitur kontrata të nënshkruara të shoqëruara me vërtetim për realizimin e tyre, këto kontrata dhe vërtetime realizimi mungojnë. KVO vendosi që B.O.E “ENEAS MASLLAVICA & VJOLLCA OSMANI” të mos kualifikohen.* “, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se me dokumentacionin e paraqitur ankimuesi vërteton se ka kryer furnizime të ngjashme me objektin e prokurimit vërtetuar më fatura tatimore shitje të lëshuara për ente publike, duke dëshmuar të gjitha kapacitetet për të kryer furnizimin me mallrat e kërkuara nga ana e autoritetit kontraktor. Autoriteti kontraktor nuk mund të pretendojë që këto fatura tatimore shitjeje nuk janë të shoqëruara me kontratën e nënshkruar me entin publik dhe vërtetimin e realizimit të lëshuar nga ky i fundit, pasi një gjë e tillë është në tejkalim të parashikimit të nenit 40, pika 7, të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, pasi në rastin e prokurimit të mallrave me blerje të vogël nënshkrimi i faturës tatimore të lëshuar nga fituesi i kësaj procedure prokurimi do të kenë vlerën e kontratës për sa kohë ato janë të firmosura dhe vulosura sipas legjislacionit tatimor, ndërkohë që nëse autoriteti kontraktor do të kishte dyshime për vërtetësinë e këtyre faturave tatimore mund të përdorte momenti procedural të parashikuar në nenin 66, të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, duke bërë verifikimet përkatëse pranë këtyre enteve publike lidhur me faktin nëse kanë lidhur apo jo kontrata me anëtarët e bashkimit të shoqërive *“Enea Masllavica Person Fizik & Vjosa Osmani person fizik”*.

Nisur nga sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se faturat tatimore të shitjes të dorëzuara nga ankimuesi kanë vlerën e kontratës, duke vërtetuar se bashkimit të shoqërive *“Enea Masllavica Person Fizik & Vjosa Osmani person fizik”* ka kryer furnizime të ngjashme me kontratën objekt ankimi, duke treguar kapacitetet e këtij operatori për të kryer furnizimin me mallrat e kërkuara nga ana e autoritetit kontraktor. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, ankimuesi e ka përmbushur kriterin e kualifikimit duke vërtetuar kështu se disponon kapacitetet në lidhje me eksperiencat e mëparshme të kërkuara nga autoriteti kontraktor për të realizuar këtë kontratë.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, Vendim i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos**

1. Të pranojë ankesën e paraqitura nga operatori ekonomik “MUCA” SHPK për procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozim”, me nr. REF-87845-02-22-2021, me objekt: “Blerje uniforme për Policinë Bashkiake”, me fond limit 3.666.000 lekë (pa TVSH), zhvilluar më datë 05.03.2021, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.
  2. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Enea Masllavica” Person Fizik për procedurën e mësipërme të prokurimit.
  3. Autoriteti kontraktor të anultojë vendimin e KVO-së lidhur me skualifikimin e shoqërive “MUCA” SHPK dhe “Enea Masllavica” Person Fizik, duke i kualifikuar ata.
  4. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
  5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatorët ekonomikë “MUCA” SHPK dhe “Enea Masllavica” Person Fizik.
  6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**Nr. 503 Protokolli      Nr. 517 Protokolli**  
**Datë 30.03.2021      Datë 01.04.2020**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Jonaïd Myzyri**